
Komentar mbi Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut, me datë 4 nëntor 2025



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

RREZIKU I HUMBJES SË DINAMIKËS

**Komentar mbi Raportin
e Komisionit Evropian për
Republikën e Maqedonisë së Veriut,
me datë 4 nëntor 2025**

RREZIKU I HUMBJES SË DINAMIKËS

Botuesi:

Instituti për politikë evropiane - Shkup,
përfaqësuar nga Dr. Simonida Kacarska, Drejtoreshë

Autorët:

Angella Delevska-Radevska

Dr. Ardita Abazi Imeri

Mr. Ardita Vejseli

Mr. Beba Zhagar

Mr. Juliana Karai

Mr. Stefan Ristovski

Mr. Fikria Tair-Selmani

Dizajni grafik:

Relativ

Shkup, Nëntor 2025

PËRMBAJTJA

4	Hyrje
6	Gjetjet kryesore sipas klasterëve
6	Klasteri 1. Themelet
13	Klasteri 2. Tregu i brendshëm
13	Klasteri 3. Konkurrenca dhe rritja inkluzive
14	Klasteri 4. Agjenda e Gjellbër dhe Konektiviteti i Qëndrueshëm
15	Klasteri 5. Burime, bujqësi dhe kohezion
16	Klasteri 6. Marrëdhëniet e jashtme
17	Vëzhgimet përfundimtare
18	Aneks 1: Niveli i konsolidimit dhe përparimit

HYRJE

Raporti i zgjerimit, nga viti 2025, është i pari i hartuar nga Komisionerja Martha Kos, nën mandatin e dytë të Ursula von der Leyen. Këtë vit, Komisioni, në fjalinë e parë të Strategjisë së Zgjerimit si një dokument kornizë i paketës së përgjithshme, thekson se **sfidat gjeopolitike kanë forcuar unitetin në BE, dhe se çdo zgjerim e ka bërë Bashkimin më të fortë**. Strategjia e Zgjerimit 2025 e Komisionit Evropian konfirmon transformimin e zgjerimit nga një proces teknik në një strategji gjeopolitike. Mes paqëndrueshmërisë së sigurisë dhe kanaleve të reja të ndikimit, Komisioni shprehet qartë se integrimi i Ballkanit Perëndimor është çështje e sigurisë evropiane, jo një ushtrim burokratik.

Strategjia thekson integrimin gradual në tregun e përbashkët të BE-së, duke theksuar se është një mjet për të mbështetur zgjerimin, jo për ta zëvendësuar atë. Në këtë kontekst, strategjia thekson se përafrimi i legjislacionit dhe kapaciteti për të zbatuar legjislacionin e BE-së është një kusht thelbësor për përdorimin e këtij mjeti. Theksohet se marrëveshjet për qasjen në tregun e brendshëm do të përfshijnë një kornizë të fuqishme institucionale dhe masa mbrojtëse ligjore dhe mekanizma për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përputhje me traktatet e BE-së, për të siguruar integritetin e tregut të brendshëm dhe zbatimin e qëndrueshëm të së drejtës së Bashkimit. Strategjia paraqet nismat aktuale për roaming, SEPA, dhe përmend mundësitë tashmë të njohura për integrim, siç janë bujqësia, shërbimet konfidenciale, hapësira, kujdesi shëndetësor, transporti dhe mbrojtja si nisma të reja.

Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor përmendet si një iniciativë që mbështet dhe përgatit vendet e zgjerimit për anëtarësim. Strategjia thekson se instrumenti i reformës dhe rritjes, ndihmon në zbatimin e legjislacionit të BE-së për t'u integruar gradualisht në pjesë të tregut të vetëm dhe për të lehtësuar rrugëtimin drejt anëtarësimit. Maqedonia e Veriut, së bashku me Malin e Zi dhe Shqipërinë, janë vendet e vetme në rajon për të cilat Komisioni ka marrë vendime për lirimin e fondeve të parafinancimit dhe reformës, të cilat duhet të kishin përfunduar deri në dhjetor 2024 dhe qershor 2025.

Risi e rëndësishme janë afatet/datat e synuara **për mbylljen e negociatave, të cilat Komisioni** i përmend në Strategji, duke vënë në dukje se për herë të parë që nga viti 2014, zgjerimi është një mundësi reale. Komisioni thekson se Mali i Zi dhe Shqipëria planifikojnë të mbyllin negociatat deri në fund të vitit 2026 dhe 2027, respektivisht. Serbia, Moldavia dhe Ukraina kanë shpallur gjithashtu datat e mbylljes të bisedimeve për pranim. Kjo ndarje konfirmon se logjika e një “pakete rajonale” në zgjerim nuk ka qenë e vlefshme tani më për disa kohë. Për më tepër, në kontekstin e zgjerimit të ardhshëm, Komisioni njofton se po shqyrton futjen e masave mbrojtëse për të parandaluar zmbropsjen në fushën e sundimit të ligjit të shteteve të reja anëtare, përmes **marrëveshjeve të ardhshme të pranimi**, por edhe për të përfutur mbështetjen e shteteve anëtare.

Ndonëse u paralajmërua disa herë, Komisioni ende nuk e ka hartuar dokumentin për analiza të politikave dhe reformave të nevojshme pas zgjerimit, i cili përsëri thuhet se është në proces të përgatitjes.

Si çdo vit, Strategjia përcjell mesazhet kryesore në lidhje me rrjedhën e procesit të pranimit dhe negociatave. Në pjesën kryesore të Strategjisë: Me konkluzionet dhe rekomandimet në lidhje me Maqedoninë e Veriut, konstatohet se institucionet vazhduan punën me udhërrëfyesit për sundimin e ligjit, reformën e administratës publike dhe funksionimin e institucioneve demokratike, si dhe planin e veprimit për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Përveç hapave vendimtarë dhe të shpejtë që janë të nevojshëm për përcaktuesit për hapjen e negociatave, Komisioni thekson se nuk janë ndërmarrë hapa për miratimin e amendamenteve kushtetuese. Nga aspekti formal i procesit të anëtarësimit, Komisioni informon se raportet e shqyrtimit (screening) për të gjashtë grupet tematike janë paraqitur në Këshill, dhe theksohet më tej se shteti duhet të zbatojë reforma thelbësore të ndërlidhura me BE-në.

Në këto rrethana të ngecjes nga aspekti formal, që në rastin e Maqedonisë së Veriut janë bërë praktikë e zakonshme, raporti për vitin 2025 përsëri vë në dukje se, pa një proces aktiv negociatash, reformat ecin ngadalë. Këtë vit, lëvizjet janë kryesisht rezultat i detyrimeve që burojnë nga Agjenda e Reformave, si pjesë e Planit për Rritje.

Lidhur me raportin e vendit, ndonëse Komisioni Evropian nuk konstaton prapambetje në asnjë fushë, gjegjësisht kapitull, por shqetëson fakti se është vlerësuar se nuk ka pasur përparim në Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe progresi i kufizuar në Kapitullin 24: Drejtësia, liria dhe siguria, kapitujt kryesorë mbi sundimin e ligjit, vendimtar për ritmin e negociatave.

Sa i përket marrjes së detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi, shteti ende e ruan nivelin e moderuar të përgatitjes, me një përmirësim të lehtë vetëm në një kapitull – Lëvizja e lirë e kapitalit, si rezultat i përmbushjes së detyrimeve për anëtarësim në Zonën e Vetme të Pagesave të BE-së. Nëse shikojmë të gjitha vendet kandidate aktualisht, përputhshmëria jonë e përgjithshme nuk është e papërfillshme, por tashmë është e qartë përparësia e Malit të Zi dhe përshejtimi i procesit të përafrimit të Shqipërisë si “udhëheqëse” të procesit¹.

Përparimi është i mirë në katër kapituj,² ndërsa në pjesën tjetër, në masë të madhe, ka vetëm lëvizje të vogla ose stagnim. Këtu, padyshim që qëndrojmë më dobët se vendet e tjera kandidate, për të cilat vlerësohet se kanë bërë më shumë përparim gjatë vitit të kaluar, veçanërisht Mali i Zi, Shqipëria, Ukraina dhe Moldavia, të cilat Komisioni i veçon si shtetet kandidate që janë në krye të procesit. Nëse ky trend vazhdon, ekziston rreziku që të humbasim hapin me vendet e tjera sa i përket nivelit relativisht të lartë të përputhshmërisë, i cili në rastin e Maqedonisë është arritur shumë më herët se te kandidatët e tjerë.

Në këtë koment, analizojmë tendencat në nivel të klasterit/kapitullit në raportin e vitit 2025, me fokus te pikat kyçe kritike, si dhe te rekomandimet e reja të Komisionit. Në fund të komentit, përfshihet një analizë e pajtueshmërisë në vitet e kaluara.³

1 Shih përmbledhjen krahasuese të gatishmërisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor: Moldavia, Ukraina dhe Gjeorgjia, në linkun e mëposhtëm: <https://epi.org.mk/post/32330>

2 Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit; Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi; Kapitulli 29: Bashkimi doganor; dhe Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes.

3 Komentet e EPI mbi raportin e KE 2011 do ta gjeni në: <https://bit.ly/4nFMPC2>

GJETJET KRYESORE SIPAS KLASTEREVE

Klasteri 1. Themelet

Funksionimi i institucioneve demokratike

Në këtë fushë, ku ndiqen zgjedhjet, puna e Kuvendit, funksionimi i Qeverisë, si dhe shoqëria civile, Komisioni Evropian konstaton se funksionimi i institucioneve demokratike, në përgjithësi, është i qëndrueshëm.

Sa i përket **zgjedhjeve**, konstatohet se Kodi Zgjedhor, i ndryshuar në mars të vitit 2024, siguron një kornizë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, por rekomandimet e mbetura të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias vazhdojnë të mbeten të paplotësuara për një periudhë të gjatë. Këtë vit, në fakt, ndryshimi i Kodit Zgjedhor ishte pjesë e Agjendës së Reformave, si një hap reformues që shteti nuk e përmbushi.

Kuvendi, ashtu si edhe në vitet e fundit, vlerësohet se funksionon në mënyrë efektive dhe përdor në mënyrë të qëndrueshme flamurin e BE-së gjatë procedurave. Megjithatë, siç është theksuar edhe në disa raporte të viteve të kaluara, konstatohen polarizime politike, të cilat ndikojnë në vonesën e miratimit të masave të rëndësishme reformuese dhe të disa emërimeve. Kuvendi duhet të përshpejtojë reformat e nevojshme në fushën e integritetit evropian, të planifikojë dhe të miratojë me kujdes axhendat dhe të kufizojë përdorimin e procedurave të shkurtuara për miratimin e ligjeve.

Lidhur me **qeverinë**, pavarësisht nga disa përparime, një reformë gjithëpërfshirëse e vetëqeverisjes lokale është ende e nevojshme urgjentisht, dhe dialogu midis niveleve të ndryshme të qeverisjes duhet të forcohet. Marrëdhëniet ndëretnike mbeten të qëndrueshme dhe Marrëveshja Kornizë vazhdon të zbatohet.

Duhet të vazhdojë forcimi i **strukturave të integritetit evropian**, për të arritur koordinimin efektiv midis ministrive të linjës dhe institucioneve, si dhe për të forcuar ekspertizën e administratës publike, në lidhje me legjislacionin evropian.

Sa i përket **shoqërisë civile**, KE ka apostrofuar si inkurajues progresin, aktivizimin e Këshillit për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile. Në këtë drejtim, Këshilli duhet të përmbushë në mënyrë efektive rolin e tij. Qeveria duhet të shtojë përpjekjet për të siguruar përfshirjen e shoqërisë civile në të gjitha fushat prioritare dhe në aktivitetet konsultative. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe financiar për sigurimin e financimit transparent të organizatave të shoqërisë civile nuk janë miratuar ende.

Reforma e administratës publike

Edhe këtë vit, ashtu si në vitin 2023 dhe në vitin 2024, Komisioni Evropian vlerëson se vendi është **mesatarisht i përgatitur**, por ndryshe nga vitet 2023 dhe 2024, kur ishte konstatuar një përparim i kufizuar (për shkak të Ligjit për organizimin e administratës shtetërore dhe Strategjisë së re për reformën e administratës publike), në këtë raport vërehet **njëfarë përparimi** për shkak të fushës së qeverisjes elektronike, përkatësisht ndryshimeve në Ligjin për dokumentet elektronike, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme. Gjithashtu, në korrik 2025, u miratuan ligjet e shumëpritura për nëpunësit administrativë dhe punonjësit e sektorit publik. Rekomandimet e KE-së nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme në drejtim të zbatimit të ligjeve të lartpërmendura që u miratuan. Ashtu si disa vite më parë, Komisioni thekson se ka fragmentim në shërbimin civil dhe paralajmëron se nuk ka politika për mbajtjen e punonjësve. Megjithëse janë bërë ndryshime pozitive në drejtim të vlerësimit të ndikimit të rregullimit, cikli i hartimit dhe koordinimit të politikave, pa përgatitjen dhe pjesëmarrjen e duhur, si dhe mungesa e vlerësimit, mbetet ende një sfidë.

23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Ndryshe nga viti i kaluar, kur ka pasur progres të kufizuar në Kapitullin 23, këtë vit në këtë fushë **nuk ka progres**, ashtu si në vitin 2023. Kjo në përgjithësi është për shkak të presioneve mbi gjyqësorin, si dhe tragjedisë në Koçan, të 16 marsit të këtij viti. Nga ana tjetër, niveli i pajtueshmërisë mbetet i pandryshuar nga viti 2019, d.m.th. në këtë raport, Maqedonia e Veriut ka **nivel të caktuar/mesatarisht të avancuar** të përgatitjes.

Gjyqësori

Vihet re se zbatimi i Strategjisë së Sektorit të Zhvillimit për Gjyqësorin (2024-2028) ka filluar, megjithatë, niveli i zbatimit deri më tani ka qenë i ulët për shkak të fillimit me vonesë të punës së Këshillit për monitorimin e zbatimit të tij. Në të njëjtën kohë, vërehet se ka ndërhyrje dhe presion nga degët e tjera të qeverisjes, veçanërisht ndaj anëtarëve të Këshillit Gjyqësor për të dhënë dorëheqjen. Vërejtje që përsëritet nga vitet e mëparshme janë burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore, dhe rrjedhimisht mungesa e progresit në zbatimin e strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore, nga viti 2020, në gjykatat dhe në prokuroritë publike.

Në lidhje me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë, konkluzioni i përgjithshëm është se ata duhet të shtojnë përpjekjet për të mbrojtur pavarësinë, integritetin dhe profesionalizmin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Si Këshilli Gjyqësor ashtu edhe Këshilli i Prokurorëve Publikë bëjnë përpjekje për të përmirësuar transparencën e punës së tyre, por Komisioni Evropian kërkon shpjegime të hollësishme të vendimeve të tyre, veçanërisht në lidhje me përzgjedhjen, emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, njëjtë si në raportin e mëparshëm vjetor.

Është e nevojshme të përmirësohet pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit, ndërsa niveli i perceptuar i besimit në gjyqësor mbetet shumë i ulët. Përfshirja e funksionarëve të lartë dhe e përfaqësuesve nga degë të tjera të pushtetit në punët e gjyqësorit paraqet shqetësim serioz, veçanërisht duke pasur parasysh interpelancën ndaj anëtarëve të Këshillit Gjyqësor në Kuvend, si dhe deklaratat e përsëritura nga politikanë të rangut të lartë të cilat, sipas Komisionit, përbëjnë ndikim të tepruar ose frikësim dhe e minojnë pavarësinë e gjyqësorit. Lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës së Lartë, vlerësohet se ajo ngre shqetësime për ndikimin e mundshëm, ndërkohë që ka edhe raste të devijimeve në renditjen gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve.

Mungesa e kuadrit gjyqësor dhe prokurorial vazhdon të theksohet si një sfidë sistematike serioze, e pranishme prej disa vitesh me radhë, e cila është përkeqësuar më tej për shkak të vonesës në fillimin e gjeneratës së nëntë të dëgjuesve të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, si pasojë e mungesës së fondeve të parashikuara në buxhetin shtetëror për vitin 2025. Këto kufizime, së bashku me numrin e shtuar të lëndëve të pazgjidhura dhe zgjatjen e proceseve gjyqësore, kontribuojnë në rënien e mëtejshme të cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë. Për më tepër, theksohet se sistemet e vjetruara të TIK-ut, përfshirë edhe sistemin e pabarmonizuar AKMIS dhe sistemin e papërfunduar të informacionit për menaxhimin e lëndëve në prokurorinë publike, e pengojnë digjitalizimin, transparencën dhe modernizimin e sistemit gjyqësor.

Lufta kundër korrupsionit

Ashtu si vitin e kaluar, Maqedonia e Veriut në luftën kundër korrupsionit ka midis **një nivel të caktuar dhe të moderuar të përgatitjes dhe nuk shënon progres** në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Korrupsioni mbetet i përhapur dhe shkakton shqetësim serioz, dhe në veçanti përmendet tragjedia e 16 marsit 2025 në Koçan, e cila zbuloi sfida sistematike në zbatimin e masave anti-korrupsion. Në fushën e kuadrit institucional, aktakuza e ngritur kundër Kryetares së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) shënohet si një ngjarje që vë në dyshim besueshmërinë e institucionit. Në prokuroritë publike, nga 14 qendra hetimore, 5 janë plotësisht funksionale, por ende mungojnë burimet njerëzore dhe financiare. Sërish vërehen pasojat e ndryshimeve në Kodin Penal të vitit 2023, për shkak të të cilave në disa raste gjyqësore ka vonesa, dhe në fund ato parashkruhen ose përfundojnë me dënime minimale, gjë që përforcon skepticizmin e publikut për efektivitetin e luftës kundër korrupsionit. Rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar plotësisht dhe mbeten për t'u zbatuar, dhe theksohet veçanërisht nevoja për miratimin e një Kodi të ri Penal.

Të drejtat themelore

Vlerësimi i të drejtave themelore mbetet i **përafruar pjesërisht me standardet e BE-së**, me probleme serioze në zbatimin sistematik të kuadrit ligjor. Rekomandimet e vitit të kaluar janë përmbushur pjesërisht dhe mbeten të njëjta. Theksohet sërish nevoja për mbështetje financiare për Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe për Avokatin e Popullit, si dhe përmirësimi i kushteve në burgje. Vijon të theksohet nevoja për miratimin e ndryshimeve në ligjin për Avokatin e Popullit, të cilat janë të nevojshme për marrjen e statusit të akreditimit "A", bazuar në parimet e Parisit. Përveç kësaj, theksohet nevoja për zgjedhjen e një Avokati të ri të Popullit, mandati i të cilit skadoi në korrik 2025 dhe i zëvendësve të tij.

Raporti i vitit 2025, si shumë vite më parë, vë në dukje në mënyrë kritike përkeqësimin dhe kushtet shqetësuese në institucionet e paraburgimit, policinë dhe institucionet psikiatrike, duke e radhitur **Maqedoninë e Veriut në mesin e vendeve me nivelin më të lartë të shqetësimit**. Rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës nuk janë zbatuar.

Në vitin 2025 nuk është shënuar përparim në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, pasi Qeveria e ka hequr Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga lista e organeve që duhet të konsultohen detyrimisht gjatë miratimit të ligjeve, ndërsa Kuvendi ende nuk ka emëruar drejtor, gjë që e dobëson ndjeshëm pavarësinë dhe aftësinë e saj për të zbatuar Strategjinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën 2025–2030.

Progres i kufizuar është bërë në fushën e lirisë së fjalës, me të njëjtat rekomandime si vitin e kaluar. Sulmet ndaj gazetarëve vazhdojnë me një numër veçanërisht të shtuar të sulmeve ndaj gazetarëve. Në vitin 2025 është përmirësuar pavarësia financiare e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, falë rritjes së mjeteve buxhetore, por shpërndarja jotransparente e reklamimit në mediat komerciale dhe dyshimet për përzgjedhjen jotransparente të anëtarëve të rinj të Këshillit të Agjencisë ngjallin shqetësime për ndikim politik dhe cenim të pavarësisë së mediave.

Në fushën e të drejtave të grave, theksohet përsëri zbatimi i dobët i Konventës së Stambollit dhe Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore. Dhuna me bazë gjinore dhe gjuha e urrejtjes janë gjithnjë e më të zakonshme dhe institucioneve ende u mungojnë mekanizmat efektivë për të mbrojtur dhe mbështetur viktimat.

Në fushën e të drejtave të fëmijëve, theksohet nevoja për krijimin e një organi koordinues kombëtar për zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Theksohet nevoja për Planin Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve për periudhën 2025–2029, i cili u miratua në gusht 2025.

Lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, është miratuar Ligji për Qasjen e Uebfaqeve dhe Aplikacioneve Mobile të Institucioneve të Sektorit Publik, por pengesat infrastrukturore dhe sociale janë ende të pranishme. Mbrojtja ligjore e personave LGBTIQ mbetet e pamjaftueshme, dhe diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes janë ende të përhapura, veçanërisht në rrjetet sociale. Theksohet nevoja për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë e personave nga komuniteti LGBTIQ, dhe vendimi i GJEDNJ i vitit 2019 për njohjen ligjore të gjinisë nuk është zbatuar. Për më tepër, në procedurë të përshpejtuar dhe pa konsultim, u miratuan ndryshimet në ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm, të cilat hoqën përmbajtjen në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe barazinë gjinore, gjë që ngriti shqetësime në lidhje me respektimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe me standardet ndërkombëtare.

Për të drejtat e romëve, ka pasur përparim të kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Romëve për periudhën 2022–2030, me caktimin e një koordinatori kombëtar, por strategjia nuk ka një qasje të qartë për sa i përket pjesëmarrjes, ngritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimi ndërinstitutional mbetet i dobët. Në këtë raport, ashtu si në të kaluarën, theksohet vazhdimisht nevoja për zbatimin e Strategjisë “Një shoqëri për të gjithë”.

24. Drejtësia, liria dhe siguria

Në Kapitullin 24: Drejtësia, liria dhe siguria, Maqedonia e Veriut mbetet e **përgatitur mesatarisht** për zbatimin e legjislacionit të BE-së, ashtu si në raportin e vitit të kaluar. Ka një ndryshim në nivelin e progresit, i cili u vlerësua më mirë vitin e kaluar, dhe këtë vit vendi konsiderohet të ketë **progres të kufizuar** në këtë fushë. Vlerësimi i vitit të kaluar ishte për shkak të progresit të bërë në fushën e konfiskimit duke përafruar legjislacionin vendas me legjislacionin e BE-së, si dhe zbatimin e marrëveshjes së re me Frontex. Sivjet vërehet se Maqedonia e Veriut duhet të forcojë kapacitetet e saj për të luftuar të gjitha format e krimit të rëndë dhe të organizuar, ndërsa në fushën e migracionit dhe azilit, nuk ka harmonizim të mëtijshëm me legjislacionin e BE-së. Rekomandimet e vitit të kaluar u përmbushën pjesërisht dhe mbeten të vlefshme.

Shteti është vlerësuar në kufirin ndërmjet një niveli mesatar dhe të caktuar përgatitjeje në **luftën kundër krimit të organizuar**, me përparim të kufizuar, ndryshe nga viti i kaluar kur ishte shënuar njëfarë përparimi. Sa i përket kuadrit institucional, Qendra Kombëtare e Koordinimit për Luftimin e Krimit të Organizuar është funksionale, por i mungojnë burimet, si dhe qendrat hetimore, të cilat janë të integruara në disa prokurori publike. Sa i përket Agjencisë Kombëtare për Siguri, përsëri theksohet se, për të siguruar pavarësi të plotë, ajo nuk duhet të vazhdojë të funksionojë në ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa AOT nuk duhet të mbetet në të njëjtat hapësira me një operator kombëtar të telekomunikimeve. Duhet të sigurohen burime adekuate financiare dhe njerëzore për të siguruar funksionimin e duhur të AOT-së. Është konstatuar një numër në rritje i hetimeve dhe dënimeve të formës së prerë në fushën e krimit të organizuar, si dhe progres në ngrirjen dhe konfiskimin e pasurisë. Vlerësohet një nivel i mirë bashkëpunimi operacional me EUROPOLIN.

Në trajtimin e **trafikimit të qenieve njerëzore**, kuadri ligjor konsiderohet të jetë vetëm pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së. Duhet të ndryshohet për ta përafruar atë me Direktivën për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe me Direktivën e rishikuar, e cila hyri në fuqi në korrik 2024.

Në fushën e **drogave**, përsëritet rekomandimi se nevojitet bashkëpunim i përmirësuar. Në **luftën kundër terrorizmit**, Maqedonia e Veriut ka një nivel të kënaqshëm të zbatimit, por kuadri ligjor për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe qëndrueshmërinë e subjekteve kritike nuk është në përputhje me legjislacionin e BE-së, kështu që mbrojtja e infrastrukturës kritike dhe qëndrueshmëria e subjekteve kritike duhet të përmirësohet.

Në **bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale**, progresi është i kufizuar dhe rekomadohet bashkëpunim i përmirësuar në çështjet civile dhe penale. Kuadri ligjor për menaxhimin e **migracionit** legal dhe ilegal është pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së, prandaj menaxhimi i migracionit duhet të përmirësohet.

Në fushën e **azilit**, vërehet përsëri harmonizimi i pjesshëm me legjislacionin e BE-së. Nevojiten përmirësime në cilësinë e procedurave të azilit dhe shtim i personelit për trajtimin efikas të rasteve. Nevojiten gjithashtu përpjekje të mëtijshme për të adresuar bashkimin e vonuar familjar të personave nën mbrojtje plotësuese, veçanërisht të të miturve të pashoqëruar.

Në **politikën e vizave**, Maqedonia e Veriut në masë të madhe është përafruar me regjimin e BE-së dhe ka treguar përparim të mirë. Për **kufijtë Shengen dhe kufijtë e jashtëm**, kuadri ligjor është pjesërisht në

përputhje me atë të BE-së. Si rekomandim, thuhet se është e nevojshme të vazhdohet forcimi i qeverisjes kombëtare të Shengenit duke krijuar një Plan Veprimi të Shengenit, i cili mbulon të gjithë kuadrin e Shengenit.

Legjislacioni për parandalimin e **falsifikimit të monedhave** është në përputhje me standardet e BE-së.

Siç thuhet në hyrje, për shkak të rëndësisë së këtij kapitulli për procesin e përgjithshëm të pranimit, është e nevojshme që Qeveria të angazhohet seriozisht për zbatimin e rekomandimeve, së bashku me Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

Kriteri ekonomik

Niveli i mirë i përgatitjes për sa i përket një ekonomie tregu funksionale dhe gatishmëria e moderuar për t'u marrë me presionin e forcave të tregut në tregjet evropiane për sa i përket kriterit ekonomik mbeten të pandryshuara këtë vit. Këtë vit, në bazë të segmentit të parë të kriterit, regjistrohet vetëm “progres i kufizuar”, ndërsa për të dytin mbetet i njëjti nivel “i caktuar” progresi.

Ekonomia funksionale e tregut

Në këtë segment, rekomandimet nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten në masë të madhe të vlefshme. Komisioni bën thirrje që t'i kushtohet vëmendje e veçantë miratimit të rregulloreve të mbetura për zbatimin e Ligjit për Buxhetin. Ai nxit gjithashtu ndjekjen e rregullave fiskale të Bashkimit Evropian, ndër të tjera, përmes rritjes së të ardhurave dhe kontrollit të shpenzimeve rrjedhëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e rritjes së pagave dhe pensione në sektorin publik, të cilat kanë ndikuar në tejkalimin e deficitit buxhetor të planifikuar. Komisioni vë në fokus zbatimin e planit të veprimit për menaxhimin e investimeve publike dhe miratimin e planit të rishikuar të veprimit për formalizimin e ekonomisë joformale.

Kapaciteti për të përballuar forcat e tregut në BE

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore në këtë fushë janë përqendruar në tre drejtime: tregun e punës, infrastrukturën e transportit dhe prodhimin e energjisë. Vërehet përparim në lidhje me reformën e arsimit profesional, por konstatohet se arsimi i lartë ende vuan nga programe mësimore të vjetruara, ndërsa tregu i punës përballët me mospërputhje të aftësive të kërkuara. Megjithatë, rekomandimi kryesor ka të bëjë me rritjen e burimeve financiare dhe njerëzore për përsheptimin e reformave në sistemin e arsimit dhe trajnimit profesional, si dhe për zbatimin e Ligjit për Arsimin e Mesëm. Komisioni bën thirrje për përfundimin e korridoreve rrugore VIII dhe X, si projekte kyçe në infrastrukturën e transportit, si dhe për rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, duke përfshirë edhe miratimin e Ligjit të ri për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë. Raporti thekson se projektet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, si edhe digjitalizimin e shërbimeve publike, mund të kenë ndikim pozitiv në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve vendore.

Kapitulli 5. Prokurime publike

Ashtu si në vitet 2023 dhe 2024, edhe këtë vit Komisioni Evropian e vlerëson Maqedoninë e Veriut si mesatarisht të përgatitur, me përparim të kufizuar falë versionit të përditësuar të sistemit elektronik të prokurimeve publike. Rekomandimet nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në periudhën e ardhshme, Komisioni konstaton se ka vonesa në finalizimin e Ligjit për Partneritet Publik-Privat dhe rekomandon miratimin e tij. Në kontekstin e udhëzimeve të hartuara për përdorimin e kriterëve cilësorë të dhënies së kontratave, rekomandohet zbatimi më i gjerë i kriterit të ofertës ekonomikisht më të favorshme (MEAT), i cili aktualisht mbetet i kufizuar. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, është rekomandimi për forcimin e kontrollit në prokurimet publike, përmirësimin e koordinimit në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e kapaciteteve për zbatimin e parimeve të transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Kapitulli 18. Statistikat

Edhe këtë vit, ashtu si në vitin 2024, Komisioni Evropian e vlerëson vendin si **mesatarisht deri mirë të përgatitur**, ndryshe nga viti 2023 kur ishte vlerësuar si mesatarisht i përgatitur, gjë që atëherë i atribuohet nivelit të lartë të përputhshmërisë së arritur të infrastrukturës statistike me të drejtën e BE-së. Ndryshe nga viti 2023, kur **është shënuar përparim i mirë**, për shkak të publikimit të të dhënave të regjistrimit të popullsisë, në dhjetor 2022, në vitin 2024 dhe këtë vit, ka pasur **një përparim të caktuar** në fushën e statistikave të tregut të punës dhe transmetimit të fuqishëm të statistikave. Rekomandimet e Komisionit Evropian nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe mbeten edhe më tej.

Kapitulli 32. Kontrolli financiar

Këtë vit, si në vitin 2024, Maqedonia e Veriut është **e përgatitur mesatarisht** për aderim, dhe ndryshe nga viti i kaluar kur përparimi ishte i kufizuar, këtë vit kishte **përparim të caktuar**. Kjo është për shkak të miratimit të Ligjit **për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik**, pasi kaloi katër vjet në procedurat parlamentare. Prandaj, rekomandimet janë modifikuar dhe përqendrohen në zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik. Nga pikëpamja legislative, Komisioni rekomandon forcimin e pavarësisë së Zyrës Shtetërore të Auditimit, ndër të tjera, përmes miratimit të Ligjit për Auditimin e Shtetit, forcimit të mbikëqyrjes parlamentare të raporteve të auditimit dhe ndjekjes së rekomandimeve të Zyrës Shtetërore të Auditimit.

Klasteri 2. Tregu i brendshëm

Në klasterin Tregu i brendshëm, ashtu si edhe në të gjithë raportin, pra në të gjitha fushat, vërehet një përmirësim i nivelit të përgatitjes në **një nga nëntë kapitujt: 4. Lëvizja e lirë e kapitalit**. Ky progres është për shkak të përmbushjes së kriterëve për anëtarësimin në SEPA dhe ndryshimeve në Ligjin për Operacionet e Këmbimit Valutor. Kapitulli 28. Ndërsa mbrojtja e konsumatorëve dhe kujdesi shëndetësor është i vetmi kapitull brenda këtij klasteri që ka shënuar përparim më të mirë, pra “të caktuar”, në krahasim me vitin e kaluar.

Në shtatë kapitujt e tjerë, për fat të keq, nuk ka pasur asnjë përparim pozitiv, as në nivelin e përgatitjes, as në aspektin e progresit. Komisioni vlerëson shprehimisht se rekomandimet nuk janë zbatuar dhe i përsërit ato në mënyrë të plotë. Ashtu si në raportin e vitit të kaluar, edhe këtë vit nuk është shënuar asnjë përparim në pesë nga nëntë kapitujt e këtij klasteri (shih aneksin).

Zbatimi i angazhimeve në këtë grup është i nevojshëm për të shfrytëzuar mundësitë e Planit të Rritjes së Ballkanit Perëndimor, si dhe për të zbatuar Planin e Përbashkët të Veprimit të Tregut Rajonal. Vihet në dukje mospërputhja e plotë me acquis-në, si dhe mungesa e kapaciteteve dhe personelit në kapitujt kyç në këtë kontekst, ndër të tjera: 1. Lëvizja e lirë e mallrave; 2. Lëvizja e lirë e punëtorëve; 3. E drejta e themelimit dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve; dhe 7. E drejta e pronësisë intelektuale.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit, të cilat janë thelbësore për rregulla të qëndrueshme dhe të parashikueshme në tregjet e BE-së. Komisioni thekson nevojën për angazhim më të madh në luftën kundër korrupsionit në lidhje me mbikëqyrjen e tregut dhe sigurinë e produkteve, si dhe forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në fushën e masave shëndetësore dhe të punësimit.

Klasteri 3. Konkurrenca dhe rritja inkluzive

Në shumicën e fushave të mbuluara nga Klasteri 3. Në fushën e konkurrueshmërisë dhe rritjes gjithëpërfshirëse, Maqedonia e Veriut është **mesatarisht e përgatitur, me zbatim të kufizuar të rekomandimeve nga viti i kaluar**. Progresi pozitiv vihet re në: Kapitullin 10: Shoqëria e informacionit dhe media; Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi; dhe Kapitulli 29: Bashkimi Doganor. Në fushën e Shoqërisë së Informacionit dhe Mediave është vërejtur njëfarë përparimi, falë miratimit të katër ligjeve kyçe për transformimin digjital, Strategjisë për Siguri Kibernetike dhe strategjisë afatgjatë për TIK me plan veprimi, si dhe përmirësimit të Portalit Kombëtar për shërbime elektronike, ndër të tjera, të përfshira në Agjendën e Reformave. Në Kapitullin 16: Në fushën e tatimeve është shënuar përparim i kufizuar përmes miratimit të Ligjit për Tatimin Minimal Global mbi Fitimin, i cili është i harmonizuar me direktivën e BE-së dhe me standardet e OECD-së. Në Kapitullin 17: Në fushën e politikës ekonomike dhe monetare, për të tretin vit me radhë, vendi ka shënuar njëfarë përparimi, me thirrje për zbatim të plotë të Ligjit për Buxhetet, zhvillimin e një sistemi të integruar të menaxhimit financiar dhe forcimin e mëtejshëm të pavarësisë së Bankës Popullore. Në Kapitullin 19: Në fushën e politikës sociale dhe punësimit ka pasur përparim të kufizuar, me një rekomandim të ri për përafrim me direktivat e BE-së mbi barazinë, baraspeshë midis jetës profesionale dhe asaj private, transparencën e pagave dhe përfaqësimin e grave në bordet drejtuese,

veçanërisht për shkak të numrit të madh të ankesave për diskriminim në punësim, kryesisht në sektorin publik. Dialogu social mbetet i dobët dhe Ligji për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve të punës nuk është zbatuar.

Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale, ka më pak progres në krahasim me vitin 2024. Megjithatë u miratua Strategjia Kombëtare e Zhvillimit për periudhën 2024-2044 dhe Strategjia për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme për periudhën 2025-2030, mungon dialogu sistematik me komunitetin e biznesit, koordinimi midis institucioneve dhe vlerësimi i ndikimit të politikave. Lufta kundër ekonomisë gri dhe thjeshtësimet administrative po stagnon, ndërsa masat mbështetëse mbeten të mbivendosura dhe jotransparente. Rëndësia e këtij kapitulli është theksuar edhe më shumë në krahasim me vitin e kaluar, pasi trajtimi i ekonomisë joformale përbën një nga hapat e përfshirë në Agjendën e Reformave.

Në Kapitullin 25: Në fushën e shkencës dhe kërkimit është vërejtur përparim i mirë, falë zbatimit të Planit të Veprimit për Strategjinë e Specializimit Inteligjent për periudhën 2024-2027 dhe rritjes së buxhetit për shkencën. Në Kapitullin 26: Në fushën e arsimit dhe kulturës ka pasur përparim të kufizuar, me miratimin e Ligjit për Arsimin e të Rriturve dhe Ligjit për Arsimin dhe Trajnimin Profesional, por miratimi i Ligjit të ri për Arsimin e Mesëm është shtyrë sërish. Në fushën e kulturës, ka vonesa në miratimin e Strategjisë për Zhvillimin Kulturor për periudhën 2023-2027, ndërsa Ministria e Kulturës duhet të forcojë kapacitetet dhe përgatitjet e Shkupit si Kryeqyteti Evropian i Kulturës për vitin 2028.

Në Kapitullin 29: Në fushën e Bashkimit Doganor **është shënuar përparim i mirë** pas dy vitesh përparim të kufizuar, përmes konsolidimit të sistemeve të TI-së dhe zbatimit të fazës së pestë të sistemit kombëtar të kompjuterizuar për tranzit (NCTS), ratifikimit të Protokollit për tregtinë e paligjshme të duhanit dhe shkallës së lartë të përputhshmërisë së legjislacionit me Kodin Doganor të Bashkimit. Me këtë, Kapitulli 29 është rikthyer sërish ndër kapitujt kryesorë me përparim të mirë, përveç nivelit të lartë të përputhshmërisë.

Klasteri 4. Agjenda e Gjelbër dhe Konektiviteti i Qëndrueshëm

Klasteri 4 mbetet me përgatitje mesatare me përparim të kufizuar, me nota identike si vitin e kaluar. Kapitulli 14: Politika e Transportit dhe Kapitulli 15: Energjetika, vendi është në një nivel mesatar përgatitjeje, me përparim të caktuar, ashtu si edhe vitin e kaluar. Përparimi në rastin e parë i atribuohet nyjes multimodale të Trubarevës, ndërsa në Kapitullin 15: Energjia, përparimi është rezultat i miratimit të Planit Vjetor për Zbatimin e Tranzicionit të Drejtë për vitin 2025 dhe të Ligjit të ri për Energjinë, të cilat ishin gjithashtu pjesë e Agjendës së Reformave. Sektori i energjisë jep një sinjal pozitiv me krijimin e Ministrisë së re për Energji, Miniera dhe Lëndë të Para Minerale, por kërkohet forcim institucional.

Kapitulli 21: Në fushën e rrjeteve transeuropiane, në Raportin e vitit 2025 vendi mbetet në **një nivel të mirë përgatitjeje**, por përsëri theksohet **progres i kufizuar**. Rekomandimet nga viti i kaluar nuk janë zbatuar, ndaj edhe në raportin e vitit 2025 përsëritet dhe nënvizohet nevoja për forcimin e kapaciteteve operacionale dhe teknike të të gjitha institucioneve dhe palëve të interesuara, për përafrimin e kornizës ligjore dhe për

rritjen e përputhshmërisë me Rregulloren për Rrjetet Transevropiane, si dhe për mobilizimin e burimeve të mjaftueshme për realizimin e objektivave dhe afateve të planit pesëvjeçar të punës së Komunitetit Transevropian.

Edhe në vitin 2025, Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike, mbeten me **një nivel të caktuar të gatishmërisë dhe progres të kufizuar**. Komisioni Evropian vlerëson se rekomandimet nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht, por i përsërit ato edhe në vitin 2025, duke theksuar nevojën për forcimin e kapaciteteve administrative dhe inspektuese, për koordinim me Mekanizmin e Bashkimit për Mbrojtje Civile, miratimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike, zbatimin e plotë të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë, si dhe funksionalizimin operacional të Njesisë për Ndryshime Klimatike pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Ashtu si vitin e kaluar, theksojmë se ky klaster është thelbësor si për sigurimin ashtu edhe për shfrytëzimin e fondeve nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, prandaj duhet të punohet sa më shpejt në përbushjen e rekomandimeve që lidhen me të.

Klasteri 5. Burime, bujqësi dhe kohezion

Klasteri 5. Burimet, bujqësia dhe kohezioni mbeten në nivel mesatar përgatitjeje, por me përparim të kufizuar dhe me ulje krahasuar me vlerësimin e vitit të kaluar për progresin. Shteti mbetet mesatarisht i përgatitur në Kapitullin 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural, por ndryshe nga viti i kaluar, kur ky ishte një nga kapitujt me përparim të mirë, këtë vit Komisioni Evropian konstaton përparim të caktuar. Vëmendja është përqendruar në nevojën për finalizimin e Ligjit të ri për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe për forcimin e kornizës së mbështetjes dhe të organizimit të përbashkët të tregjeve. Risia e këtij kapitulli këtë vit është theksi shtesë në luftën kundër korrupsionit, ku Komisioni Evropian nënvizon se organet e IPARD-it janë të detyruara të parandalojnë, zbulojnë dhe raportojnë parregullsitë.

Kapitulli 21: Siguria ushqimore, veterineria dhe politika fitosanitare nuk kanë pësuar ndryshime të rëndësishme, duke treguar sërish **një nivel të mirë përgatitjeje me përparim të caktuar**, i cili i atribuohet luftës kundër sëmundjeve të kafshët, forcimit të kontrollit fitosanitar të bimëve dhe zbatimit të masave për çrrënjosjen e dëmtuesve, bazuar në gjetjet e programeve të mbikëqyrjes fitosanitare. Ky kapitull është një nga kapitujt me nivelin më të lartë të përgatitjes për anëtarësim në rastin tonë dhe gjithashtu është vlerësuar më së larti për nga shkalla e përgatitjes ndër të gjitha vendet kandidate për anëtarësim. Si një kapitull jashtëzakonisht i rëndësishëm, është e nevojshme që ky nivel përgatitjeje të ruhet përmes një progresi më të mirë.

Në Kapitullin 13: Peshkimi, niveli i gatishmërisë mbetet mesatarisht i avancuar, por përparimi është më i dobët se vitin e kaluar. Komisioni rekomandon forcimin e kontrolleve kundër peshkimit të paligjshëm dhe rritjen e strukturave administrative për menaxhimin e politikave. Rekomandimi për përmirësimin e kontrolleve mbi menaxhimin e fondit të peshkut dhe mbi kontrollin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paregjistruar (IUU), përmes vendosjes së një Sistemi për Menaxhimin e Certifikimit të Kapjeve, i cili vitin e kaluar ishte një risi, mbetet i vlefshëm edhe këtë vit.

Në Kapitullin 22: **Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukture**, Maqedonia e Veriut u vlerësua si **e përgatitur mesatarisht me progres të kufizuar** gjatë periudhës raportuese. Rekomandimet e vitit të kaluar mbeten për t'u zbatuar këtë vit dhe vlerësimet e kapacitetit për të shfrytëzuar fondet e BE-së janë përsëri shqetësuese. Është vërejtur miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Investimeve Publike për vlerësimin dhe përcaktimin e prioritetëve të projekteve, në prill të vitit 2025, si dhe i Ligjit të ri për Nëpunësit Administrativë, në korrik të vitit 2025. Po ashtu, theksohet nevoja për përmirësimin e klasifikimit të vendeve të punës dhe të sistemit të pagave, me qëllim garantimin e stabilitetit dhe mbajtjen e kuadrove që punojnë në fushën e integritetit në BE. Megjithatë Komisioni Evropian vëren një përmirësim në cilësinë e programimit përmes grupeve sektoriale të punës, ai thekson koordinimin e dobët, raportimin dhe monitorimin e pamjaftueshëm qendror, që e vështirësojnë cilësinë e raporteve të IPA-s. Ashtu si disa vite më parë, theksojmë se kapaciteti në këtë kapitull është thelbësor për shfrytëzimin e fondeve të BE-së, ndërkohë që, për më shumë se dhjetë vjet, ka pasur përparim të kufizuar ose aspak, gjë që e vë në rrezik zhvillimin afatgjatë.

Klasteri 6. Marrëdhëniet e jashtme

Klasteri përbëhet nga dy kapituj, që lidhen me dy aspekte të marrëdhënieve të jashtme të Bashkimit, tregtia e jashtme dhe politika e jashtme: **30. Marrëdhëniet e jashtme**; dhe **31. Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes e BE-së**. Në lidhje me Kapitullin 30, vendi shënon **përparim të caktuar** (në kontrast me vitin e kaluar kur kishte përparim të kufizuar), i cili është rezultat i drejtpërdrejtë i zbatimit të protokolleve të CEFTA-s dhe përpjekjeve për të zhvilluar sistemin e tij të kontrollit të eksportit **dhe një nivel të mirë përgatitjeje**. Nga ana tjetër, në lidhje me Kapitullin 31, nuk ka ndryshime në vlerësime, sepse nuk ka ndryshime të rëndësishme në përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian, dhe tre vjet më parë ka **nivel të mirë të përgatitjes dhe përparim të mirë**.

VËZHGIMET PËRFUNDIMTARE

Raporti i Komisionit Evropian, në vitin 2025, është raporti i 19-të për vendin, pas publikimit të raportit analitik të vitit 2005. Si rezultat i përfshirjes shumëvjeçare në procesin e anëtarësimit, Maqedonia e Veriut prej vitesh ruan **një nivel mesatar përgatitjeje për marrjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi, por me përparim të ngadalshëm.**

Në këtë raport, përsëri në plan të parë vijnë **fushat në të cilat nuk kemi zbatuar reforma për vite me radhë**, si dhe forcimi i kapaciteteve, megjithëse nevojat janë më se të dukshme. Në klasterin: Themelet, progres i ngadaltë dhe ngecje janë të dukshme në Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore, ku ndërhyrjet, edhe pse të mbështetura nga Agjenda Reformuese, janë të vonuara. Nevojiten masa urgjente edhe në luftën kundër korrupsionit, të cilat ky raport i trajton si një çështje horizontale. Së fundmi, kushtet në burgjet janë kthyer në fokus, si në të gjitha 19 vitet e kaluara, pa shumë ndryshim.

Shembuj të mirë në kapitujt ende ekzistojnë, siç janë siguria ushqimore dhe doganat, por në rastin e parë, tendenca e përparimit të ngadalshëm është e pranishme prej disa vitesh me radhë. Është e nevojshme që shteti të përqendrohet në ruajtjen e këtyre shembujve pozitivë dhe t'i mbindërtojë ato edhe në klasterë dhe kapituj të tjerë.

Këtë vit, disa nga ndryshimet pozitive janë për shkak të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Rritjes **dhe në Agjendën Reformuese** (si SEPA, digitalizimi dhe energjia), gjë që tregon se ky instrument ka ndikuar pozitivisht në progresin dhe duhet të përdoret më tej. Megjithatë, Agjenda Reformuese nuk mund të zëvendësojë procesin e aderimit, i cili përfshin një transformim shumë më thelbësor. Prandaj, është e nevojshme që Qeveria të përdorë raportet e paraqitura të shqyrtimit për të identifikuar fushat në të cilat do të përqendroheshim në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, në mënyrë që të mos humbasim plotësisht vulltin në procesin e përafrimit. Masat për zbatimin e rekomandimeve nga raportet e skringut duhet të përfshihen në dokumentet që përbëjnë bazë për hapjen e klasterit të parë, si edhe në Programin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL), i cili prej kohësh është lënë pas dore, megjithëse mbetet një instrument kyç i procesit të anëtarësimit.

Kundrejt përparimit tonë të ngadaltë, vendet e tjera kandidate kanë parë një ritëm të përshpejtuar të përafrimit këtë vit. Për këto arsye, ekziston rreziku që në afat të shkurtër dhe të mesëm, të mbetemi dukshëm prapa vendeve me të cilat Komisioni Evropian në mënyrë aktive po zhvillon negociatat.

Aneks 1: Niveli i konsolidimit dhe përparimit⁴

GRUPI	SFERA/KAPITULLI	GATISHMËRI									PËRPARIM	
		2016	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2022 -2023	2024 -2025
1. THEMELET	FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMAT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
	• REFORMA NË ADMINSITRATËN PUBLIKE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	2
	23. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE	2	2	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	1	0
	• FUNKSIONIMI I GJYQËSORIT	2	2	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	1	0
	• EKONOMIA FUNKSIONALE E TREGU	2	2	2	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	0	0
	• LIRIA E SHPREHJES	2	2	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	1	1
	24. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	3	3	3	3	3	3	3	3	3	2	1
	• LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR	2	2	2	2	2	2	3	2.5	2.5	2	1
	EKONOMIA FUNKSIONALE E TREGUT	4	4	4	4	4	4	3	4	4	2	1
	AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR PRESIONIN KONKURRUES DHE FORCAT E TREGUT NË BE	3	3	3	3	3	3	2.5	3	3	2	2
	5. PROKURIME PUBLIKE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	18. STATISTIKË	3	3	3	3	3	3	2	3.5	3.5	2	2
	32. KONTROLLI FINANSIAR	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	1
2. TREGU I MBRENDSHËM	1. QARKULLIMI I LIRË I MALLËRAVE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	0	0
	2. LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0
	3. E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	4. LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT	3	3	3	3	3	3	3	3	3.5	1	3
	6. E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE	4	4	4	4	4	4	4	4	4	0	0
	7. E DREJTA E PRONËS INTELLEKTUALE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	0	0
	8. POLITIKA E KONKURRENÇËS	3	3	3	3	3	3	3	3	3	0	0
	9. SHËRBIMET FINANSIARE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	2	2
	28. MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE MBROJTJA SHËNDETËSORE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	2
3. KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE	10. SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIAT	4	3	3	3	3	3	3	3	3	1	2
	16. TATIMET	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	17. POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE	3	3	3	3	3	3	3.5	3.5	3.5	2	2
	19. POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI	3	3	3	3	3	3	3	3	3	2	2
	20. NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE	3	3	3	3	3	3	3	3.5	3.5	2	0
	25. SHKENCA DHE HULUMTIMI	4	4	4	4	4	4	4	4	4	2	3
	26. ARSIMI DHE KULTURA	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	29. BASHKIMI DOGANOR	4	4	4	4	4	4	4	4	4	1	3
4. AGJENDA E GJELBËR DHE QËNDRUESHMËRIA	14. POLITIKAT E KOMUNIKACIONIT	3	3	3	3	3	3	3	3	3	2	2
	15. ENERGJIA	3	3	3	3	3	3	3	3	3	2	2
	21. RRJETET TRANS-EUROPIANE	4	4	4	4	4	4	4	4	4	1	1
	27. MJEDISI JETËSOR	2	2	2	2	2	2	2	2	2	1	1
5. BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI	11. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL	3	3	3	3	3	3	3	3	3	2	2
	12. SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE	2	4	4	4	4	4	4	4	4	2	2
	13. PESHKIMI	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	2
	22. POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURE	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	1
	33. DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
6. MARRËDHËNIET E JASHTME	30. MARRËDHËNIET E JASHTME	3	3	3	3	3	3	3	4	4	1	2
	31. POLITIKA E JASHTME, SIGURISË DHE MBROJTJES	3	3	3	3	3	4	4	4	4	3	3

Rishikimi i notave për gatishmëri:

Assessment	Numerical value/Vlera numerike	Nota
At an early stage	1	NË FAZË TË HERSHME
Some level of preparation	2	MESATARISHT I GATSHËM
Moderately prepared	3	MESATARISHT I GATSHËM
Good level of preparation	4	NIVEL I MIRË I GATISHMËRISË
Well advanced	5	GATISHMËRI SOLIDE

Vlerësim i notave për përparim:

Assessment	Numerical value/Vlera numerike	Nota
Backsliding	(-4)-(-1)	KTHIM MBRAPA
No progress	0	NUK KA PËRPARIM
Limited progress	1	PËRPARIM I LIMITUAR
Some progress	2	NIVEL I CAKTUAR I PËRPARIMIT
Good progress	3	PËRPARIM I MIRË
Very good progress	4	PËRPARIM SHUMË I MIRË

